

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR
“KOOP-7”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 38, datë 05/04/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, si dhe të ligjit nr. 9723, datë 03/05/2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”, sot më datë 18/05/2019, hartohet ky Akt Themelimi prej anëtarëve të shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor “KOOP-7”

1. ISMIAL VELIU, i datëlindjes 18.12.1964 me karte identiteti nr. Personal G41218014J
2. ARSHI BUZI, i datëlindjes 25.02.1942, me karte identiteti nr. Personal E20225021V
3. ARSIDON BUZI, i datëlindjes 20.08.1971, me karte identiteti nr. Personal H10820246N
4. MENTOR BUZI, i datëlindjes 14.06.1970, me karte identiteti nr. Personal H00614167P
5. EDUART BUZI, i datëlindjes 05.02.1969, me karte identiteti nr. Personal G90205104P
6. NUSRET QAMILI, i datëlindjes 27.01.1967, me me karte identiteti nr. Personal G70127032E
7. BUJAR KAMBERAJ, i datëlindjes 15.02.1967, me karte identiteti nr. Personal G70215295C

Kjo shoqëri është një organizëm i krijuar me vullnetin e lirë të anëtarëve të saj, jo politike dhe e pavarur.

**NENI 1
EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Emërtimi i shoqërisë do të jetë “Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor”
“KOOP-7”

**NENI 2
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria në objekt të ushtrimit të veprimtarisë së saj do të ketë:

- *Kultivimi , perpunimi dhe tregëtimi i dru-arrorëve dhe dru-frutoreve.*
- *Importim dhe tregëtim me pakice dhe shumice të pleherave dhe farave për bujqësinë . Import-Eksport prodhime bujqësore dhe shitje me pakice e shumice . Import dhe shitje makineri bujqësore,*
- *Grumbullimin, transportin, shpërndarjen, importin, eksportin dhe tregëtimin e të gjitha prodhimeve bujqësore në gjendjen e tyre natyrale ose të përpunuar që gjenden në territorin ku vepron shoqëria për të realizuar sasi më të mëdha prodhimi për të hyrë në treg me çmime më konkurruese për shitjen e tyre.*
- *Permiresimi dhe organizimi i kultivimit të pemëve arrorë.*
- *Import-eksport i të gjitha prodhimeve bujqësore (fruta dhe perime) të freskëta e të përpunuara (industrializuara),.*

- *Nxitjen dhe organizimin e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me prodhimin dhe tregëtimin e prodhimeve të fermerëve.*
- *Kryerja e veprimtarive të punës bujqësore për anëtarët dhe të tretët.*

NENI 3

SELIA DHE TERRITORI I VEPRIMTARISË

Selia e shoqërisë do të jetë Mbrostar Ura, rruga Fier-Lushnje km5, zona kadastrale me nr:2636 dhe pasuria me nr:36/15, godine 1 kateshe .

NENI 4

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë “KOOP-7” është e pakufizuar.

NENI 5

KAPITALI

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 100'000 (Njeqindmijë) lekë i ndarë në 7 pjesë me vlerë 1 pjese 19,047.62 lek dhe 6 pjese me 13,492.06 lekë secila.

Kapitali mund të derdhet me para në dorë ose në kontribute në natyrë (objekte, tokë ose makineri).

Kontributet në natyrë shprehen në vlerë ekonomike mbi bazën e një raporti vlerësimi të bërë nga një ekspert i caktuar nga Asambleja e Anëtarëve.

Anëtarët janë pronarë të aseteve të tyre në kapitalin e shoqërisë duke qenë kështu dhe pronarë të shoqërisë në raport me kontributet në kapital.

Kapitali përkatës mund të shitet, dhurohet apo lihet në trashëgim nga secili prej anëtarëve të shoqërisë.

Në momentin e krijimit të shoqërisë kapitali fillestar është i ndarë si më poshtë përcaktuar:

1. ISMIAL VELIU me 14% dhe ne vlere 13,492.06 lek
2. ARSHI BUZI me 14% dhe ne vlere 13,492.06 lek
3. ARSIDON BUZI me 14% dhe ne vlere 13,492.06 lek
4. MENTOR BUZI me 14% dhe ne vlere 13,492.06 lek
5. EDUART BUZI me 16% dhe ne vlere 19,047.64 lek
6. NUSRET QAMILI me 14% dhe ne vlere 13,492.06 lek
7. BUJAR KAMBERAJ me 14% dhe ne vlere 13,492.06 lek.

NENI 6

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. **Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve**
2. **Administratori**, i cili me vendim të Asamblesë mund të qëndrojë në detyrë për një periudhë kohore maksimale jo më shumë se 5 vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administrator i miratuar nga mbledhja themeluese e Shoqërisë emërohet **Z. EDUART BUZI**, i cili emërohet Administrator për një periudhë 5 vjecare. Administratori ngarkohet me kryerjen e të gjitha procedurave të regjistrimit të Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 7

MËNYRA E SHPËRNDARJES SË SHOQËRISË

Shoqëria shpërndahet me vendim të mbledhjes së përgjithshme të thirrur nga administratori.

Procedura e ndjekur për shpërndarjen e saj përcaktohet në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria shpërndahet në këto raste:






- Zvogelimi i numrit të anëtarëve nën minimumin ligjor të nevojshëm, për të krijuar një shoqëri.
- Reduktimi i kapitalit të shoqërisë nën minimumin e përcaktuar në ligj, nëse nuk rivendoset brenda një periudhe gjashtemujore.
- Perfundimi i afatit të shoqërisë, sipas përcaktimeve në statut.
- Kur qëllimi i saj nuk është përmbushur apo nuk ka mundësi të përmbushet, pasi ka humbur aftësinë paguese;


Në rast shpërndarje të shoqërisë ajo pushon veprimtarinë e saj dhe vihet në likuidim nga Komisioni i Likuidimit i cili formohet sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.


Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Q.K.B. Në këtë ditë shoqëria njihet si person juridik.

Të drejtën e përfaqësimit në gjykatë të shoqërisë për të bërë regjistrimin e saj e ka administratori ose një person i autorizuar prej tij.

PËRFAQËSIA THEMELUESE:

1. ISMIAL VELIU 
2. ARSHI BUZI 
3. ARSIDON BUZI 
4. MENTOR BUZI 
5. EDUART BUZI 



6. NUSRET QAMILI Nusret Qamili 
7. BUJAR KAMBERAJ Bujar Kamberaj 